



HYSENBELLIU GROUP



PROFILI I KOMPANISË

www.hysenbelliugroup.com



Panorama

PROGRAMA
SPORT

PsikologjiA

LUARASI

FI GROUP

TIRANA
GOLDEN
PARK

EGNATIA

ERJONI
NESTRA

EGNATIA

ALB-MS

news 24

BalkanWebj

GAZETA SHQIPTARE

RASH

fab

IP
PRESTIGE

IP-IR
PRESTIGE

IP-IR
PRESTIGE

Emnifactor
Factoring Company

PËRMBAJTJA

Fjala e presidentit të grupit	03
Struktura e grupit	04
Kush është Hysenbelliu Group	06
Vlerat tona	07
Historiku ynë	08
Industria e pijeve	10
Industria e ndërtimit	17
Edukimi	21
Media Elektronike dhe e shkruar	24
Restorant / Hoteleri / Turizëm	33

FJALA E PRESIDENTIT TE GRUPIT

Të prekësh ëndrrën e gjithkujt: “Të krijosh një biznes të suksesshëm” përmes një intuitede të veçantë, iniciativës mbresëlënëse dhe me largpamësinë për të krijuar frutet e ardhshme.

Të krijosh kështu, hap pas hapi, një perandori të konsoliduar tashmë me emrin “Hysenbelliu Group”.

Biznesi duhet të jetë më shumë instikt, nuhatje. Ndonjëherë vendimet duken të çuditshme, ndoshta edhe pak të çmendura, por në fund, risku sjell edhe suksesin. Duke pasur parasysh këtë kosto, kam nisur punën për të ngritur “Hysenbelliu Group”, duke e shndërruar nga një biznes të vogël në një kompani me një portofol biznesesh të ndryshme, që sot, duke lënë modestinë mënjanë, mund të themi se janë lider në treg.



Të bësh biznes në Shqipëri nuk është e thjeshtë dhe kjo ka kërkuar që nuhatja të jetë më e fortë dhe risku, pse jo, edhe më i madh. Frika për dështim zvogëlohet kur rritja vjen gradualisht, ashtu siç ka ardhur për grupin që unë drejtoj.

Sot “Hysenbelliu Group” nuk gjendet këtu ku është thjesht si një rastësi e fatit, por si produkt i një pune të palodhur dhe mësimëve të nxjerra rrugës. Pjesë e “Hysenbelliu Group” janë disa kompani që operojnë në sektorë të ndryshëm, duke filluar që nga industria e pijeve e deri te media e shkruar, ajo elektronike, hoteleri-turizëm apo sektori i ndërtimit. Të gjitha janë ndërtuar me një vizion të qartë për misionin që do të kenë, si dhe me strategji të mirëmenduar për zhvillimin dhe arritjen e objektivave. Vizioni i secilës prej këtyre kompanive me zë në vend, integrohet në një të përbashkët me “Hysenbelliu Group”, i cili ka në qendër të tij konsumatorin dhe idenë fikse se në gjithçka që është bërë deri më sot, ka vend për përmirësim. Kjo është edhe pika jonë e fortë.

Ne besojmë se pjesën më të madhe të energjive duhet ta investojmë tek ato që kemi ndërtuar, duke i përmirësuar dhe njehsuar me cilësinë që tregu kërkon. Ne kërkojmë më të mirën, cilësinë dhe performancën më të realizuar me standardet më të larta të kohës moderne. Por, mes gjithë kësaj, lëmë vend edhe për risitë. Jemi të fokusuar në mënyrë konstante në sektorë kyç, që janë të integruar me njëri-tjetrin, ku bashkimi i secilës hallkë duhet të na japë në fund si produkt një zinxhir funksional për tregun.

Në vizionin tonë, e nesërmja nuk është një ditë tjetër mbijetese në treg, por një mundësi më shumë për t'u rritur, zhvilluar dhe për t'i dhënë hov ideve që i shërbejnë jetës së komunitetit, jetës së çdo shqiptari.

Irfan HYSENBELLIU

KUSH ËSHTË “HYSENBELLIU GROUP”

Mbi dy dekada, “Hysenbelliu Group” njihet si një nga grupet investitore më të mëdhenj në tregun vendas dhe jo vetëm. Fillesat e tij regjistrohen rreth vitit 1994.

Me po të njëjtin identitet, sot “Hysenbelliu Group” është një ndër grupet e rëndësisë së veçantë sa i takon investimeve më të mëdha që bëhen në Shqipëri e në rajon.

Portofoli i investimeve të grupit përfshin një varg biznesesh të ndryshëm: në fushën e medie elektronike e të shkruara, në fushën e edukimit, në sektorin e prodhimit dhe tregtimit të pijeve, në sektorin e ndërtimit, në sektorin bar-hoteleri-restorante etj. Në këtë përfaqësim dinjitoz vlen të përmendim kontributin e pamatë si pjesë e “Hysenbelliu Group” të emrave të njohur të bizneseve shqiptare, që nga:

“Gazeta Panorama”, “Gazeta Panorama Sport”, “Gazeta Shqiptare”, “Revista Psikologjia”, “Revista Grazia”, “News 24”, “Balkan Web”, “Radio RASH”, “Birra Korça”, “Uji Fab”, “Universiteti Luarasi”, “ALB-MS 97”, “Erjoni” Ndërtim, “Egnatia” Ndërtim, “Hotel Prestige”, dhe së fundmi e “Restorant Prestige” dhe “Prestige Holiday Resort” (ish-Mak Albania në Golem) etj.



VLERAT TONA

APLIKIMI I STANDARDEVE MË TË LARTA

"Hysenbelliu Group" ka zgjedhur të zhvillohet nëpërmjet aplikimit të standardeve më të larta në të gjitha fushat ku operon. Prirja dhe këmbëngulja janë për të ofruar cilësi dhe inovacion është vlerësuar nga klientët dhe nga tregu, duke na dhuruar motivimin për të bërë gjithmonë e më shumë drejt realizimit të projekteve të reja edhe më ambicioze për të ardhmen.

SINERGJIA BRENDA GRUPIT

Shoqëritë e grupit tonë funksionojnë dhe zhvillohen falë mbështetjes, sinergjisë dhe shkëmbimit të përvojave. Të qenit GRUP kompanish, të cilat operojnë në fusha të ndryshme krijon mundësinë që të gjitha shoqëritë tona të kenë mbështetje menaxheriale, ekspertize financiare etj.

PUNONJËSIT

"Hysenbelliu Group" i konsideron punonjësit si vlerë mjaft e rëndësishme për zhvillimin e të gjitha kompanive të saj. Punonjësit janë përzgjedhur me mjaft kujdes, bazuar mbi integritetin e lartë dhe kërkesat ambicioze që ata kanë dhe që i kërkon puna në grup. Si një ndër punëdhënësit privat më të mëdhenj në vend, me një portofol investimesh mjaft të ndryshme nga njëra-tjetra, Presidenti i kompanisë ka ndjekur me vëmendje të veçantë politika të tilla, ku punonjësit mund të marrin prioritet brenda shoqërive të Grupit.

MJEDISI DHE KOMUNITETI

Filozofia e aplikimit të standardeve të larta në "Hysenbelliu Group" ka në thellësi etikën, respektimin e vlerave, përgjegjshmërinë maksimale për punonjësit, klientët, partnerët, furnitorët, komunitetet dhe mjedisin ku operojnë shoqëritë tona.

Investimi ynë në produktet e konsumit, në edukim, në media, në sektorin e ndërtimit etj. ka në thellësi trajtimin me shumë kujdes e me prirje drejt zhvillimit të komunitetit, duke ofruar vëmendje maksimale, që aktiviteti ynë të mos ketë ndikime negative mbi mjedisin dhe shoqërinë tonë. Ky është një angazhim i yni, jo vetëm për të tashmen, por edhe për brezat e ardhshëm.

DIVERSIFIKIMI DHE ZGJERIMI

Objektivat e grupit janë diversifikim dhe zgjerim. Ne kemi investuar në sektorë të ndryshëm që sjellin zhvillim për vendin, duke krijuar hapësira për vende të reja pune, si dhe risi për tregun. Investimet tona janë të realizuara me financime të ligjshme dhe të gjitha janë të hipotekuara.



1994	1995	1997	2002	2004
			   	

HISTORIKU YNË

- 1994** Presidenti i kompanisë Z. Irfan Hysenbelliu në bashkëpunim me partnerë nga Izraeli i dha udhë biznesit privat, fillimisht në fushën e tregtisë me importimin e produkteve ushqimore.
- 1995** Kompania e Ndërtimit "Erjoni" sh.p.k filloi aktivitetin e saj tregëtar në fushën e ndërtimit në Tiranë, për t'u shtrirë më pas në të gjithë vendin.
- 1997** U krye me sukses privatizimi i një nga shoqërive më të mëdha me kapital shtetëror, të prodhimit të mjeteve mësimore, "ALB-MS 97" sh.a.
- 2001** Z. Irfan Hysenbelliu arriti të bashkonte 10 biznesmenë shqiptarë për të realizuar me sukses privatizimin e shoqërisë "Birra Tirana sh.a.". Nën drejtimin e Z. Hysenbelliu, birra "Tirana" u kthye në birrën më të suksesshme në tregun shqiptar. Pas një përvoje disavjeçare si CEO i shoqërisë "Birra Tirana", Z. Hysenbelliu vendosi të shesë aksionet e tij nga "Birra Tirana" dhe të blejë 100 % të aksioneve të Birra Korça sh.p.k.", të cilat vazhdon t'i zotërojë ende.
- 2002** Kantina e verës "Egnatia" filloi aktivitetin e saj në qytetin e Elbasanit me një kapacitet të lartë prodhimi, më i madhi në vend, i pajisur me teknologjinë më moderne të prodhimit.
- 2002** Z. Irfan Hysenbelliu i hapi udhën një investimi serioz në fushën e medias së shkruar, duke regjistruar shoqërinë mediatike "Panorama Group" sh.a, e cila përfshin: gazetën "Panorama", gazetën "Panorama Sport", revistën "Psikologjia" si dhe revistën "Grazia".
- 2004** Blihet shoqëria "Birra Korça" sh.p.k e themeluar që në vitin 1928, fabrika e së cilës iu nënshtrua një rikonstruksioni të plotë me një investim mbi 15 milion Euro.
- 2010** Kompania "Egnatia Group" sh.a shtriu aktivitetin e saj edhe më gjerë duke u përfshirë edhe në sektorin e ndërtimit. Kjo shoqëri ka qenë investitore në komplekse të ndryshme banimi në Tiranë dhe disa qytete të rëndësishme të Shqipërisë.

2010

2011

2013

2014

EGNATIA
GROUP


LUARASI

news 24

BalkanWeb

GAZETA SHQIPTARE



RASH
TIRANA
GOLDEN
PARK

GRAZIA



fab
uji natyral oligomineral



PRESTIGE
HOTEL



PRESTIGE
Holiday Resort



PRESTIGE
RESTORANT

- 2011** Hysenbelliu Group në bashkëpunim me bankierin Z. Artan Santo krijuan shoqërinë "Focus Group" sh.p.k. e cila realizoi suksesshëm blerjen e grupit mediatik që përfshin "News 24", "Gazeta Shqiptare", "Balkanweb" si dhe "Radio RASH".
- 2011** Në këtë vit, SHLUJP "Universiteti Luarasi" do t'i bashkohej portofolit të investimeve të grupit, duke sjellë brenda tij jo vetëm një diversifikim në sektorin e edukimit, por dhe një emër të madh në sistemin akademik në Shqipëri. Aktualisht, ky universitet po investon në ndërtimin me parametrat më bashkëkohorë të kampusit të ri Universitar.
- 2013** ALB-MS 97 sh.a bëhet partner në ndërtimin e kompleksit të ri të quajtur "Tirana Golden Park".
- 2013** Revista "Grazia" një emër i njohur në tregun evropian të revistave, u regjistrua si pjesë e "Hysenbelliu Group" si e vetmja revistë me patentë ndërkombëtare në Shqipëri.
- 2014** Një risi e rëndësishme në fushën e hoteleri-turizmit në Tiranë ishte dhe hapja e "Hotel Prestige".
- 2014** Uji natyral oligomineral "Fab" hyri në treg në pranverën e vitit 2014 si një nënprodukt i "Birra Korça". Lule Fabiola (në Latinisht Tritelia laxa) i dha emër dhe imazh këtij produkti të ri.
- 2014** "Restorant Prestige" u hap si një risi e radhës nga "Hysenbelliu Group" në fundvitin 2014. Brenda një kompleksi mahnitës, me të gjithë elementët e luksit të dëshiruar, gjendet vila tri-katëshe, ku gjithkush ka kënaqësinë të shijojë kuzhinën më të veçantë dhe më prestigjioze të përfaqësuar nga shefa kuzhine me përvojë perëndimore.
- 2014** Pjesë e grupit u bë dhe ish-kompleksi turistik "Mak Albania". "Prestige Holiday Resort" është emri i ri me të cilin do të rikthehet në treg ky kompleks. Pas një rikonstruksioni total të ambienteve të mëparshme dhe pas një rikonceptimi modern të arkitektëve tanë, "Prestige Holiday Resort" synon të jetë destinacioni më i frekuentuar turistik në rajon.

HB

INDUSTRIA E PIJEVE





Birra e parë Shqiptare - prej 1928

"Birra Korça" u themelua nga investitori italian Umberto Umberti nga provinca e Valdobjodenit e Venecias dhe Selim Mborja nga fshati Mborje i Korçës. Projektet për ndërtimin e fabrikës u hartuan nga arkitektë italianë në vitin 1928 dhe me vendim të parlamentit të asaj kohe dhe miratim të mbretit Zogu I, firmosur nga Pandeli Vangjeli, Mit'hat Frashëri dhe avokat Mano, nisi ndërtimi i fabrikës në tetor të vitit 1929.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe me vendosjen e pushtetit komunist në Shqipëri, më 11 janar 1946 fabrika "Birra Korça" u shtetëzua në bazë të ligjeve të asaj kohe. Në prill 1994 u bë privatizimi nga një grup aksionerësh korçarë.

Në viti 2004, shoqëria "Birra Korça" sh.p.k u ble nga investitori shqiptar Z. Irfan Hysenbelliu, aktualisht, President i "Birra Korça" sh.p.k. Me riblerjen e fabrikës nga Z. Hysenbelliu, kjo e fundit iu nënshtrua rikonstruksionit të plotë teknologjik e ndërtimor.

Nga pikëpamja ndërtimore është ruajtur koncepti arkitektural i trashëguar, duke u pasuruar me elemente të rinj të të njëjtit stil. Linja teknologjike është vendosur tërësisht e re, bashkëkohore dhe moderne, e vitit 2005, importuar nga Republika Çeke.

Duke ndërthurrur traditën dhe stilin modern, këta elementë arkitekturor bashkëjetojnë në harmoni të plotë brenda mureve të fabrikës, zbukuruar me vepra arti, si: punime në gurë, në tjegulla, në dru, kangjella, mozaikë dhe gravura basoreliev punuar në qeramikë.

Tradita e shijes së mrekullueshme dhe e cilësisë së lartë të birrës garantohej përmes një teknologjie të sofistikuar, bashkëkohore. Është ky garanti më i mirë i së tashmes dhe i së ardhmes së "Birra Korça". Aktualisht "Birra Korça" prodhon tri produkte: bionde, e zezë dhe O1.



PRODUKTET E BIRRA KORÇA

BIRRA BIONDE është birrë e tipit pilsen dhe prodhohet me metodën e veçantë të Dekoksjonit. Birra "Korça" është një birrë shumë cilësore, në bazë dhe të vlerësimeve të shumta nga prodhues të huaj të birrës apo specialistë të fushës. Karakteristikat e veçanta të saj, si shkalla alkoolike brenda standardeve, aroma e këndshme, buketi mjaft i mirë, viskoziteti u dedikohen standardeve të larta të prodhimit. Kjo birrë është 100% malto.

BIRRA E ZEZË është një birrë unike për të gjithë Shqipërinë dhe më tej në rajon. Është një tjetër birrë, varietet krejt ndryshe, që nuk ngjason fare me dy llojet e tjera të birrave, për sa i takon shijes dhe aromave. Për prodhimin e kësaj birre përdoren 4 lloje malto, të cilët i japin dhe shijen e veçantë, ku mbi të gjitha dallohet shija e lehtë e karamelizimit. Ndërkohë edhe ngjyra e birrës është plotësisht e errët (e zezë), gjë që e dallon dukshëm nga birrat e tjera. Kjo birrë është më viskoze dhe me një buket tepër specifik dhe mjaft të admirueshëm.

BIRRA 01 është një formulë tjetër birre, e cila është më e lehtë se birra bionde, falë ndërhyrjeve cilësore në recepturën e prodhimit. Birra 01 është më e lehtë në shije, me përqindje më të ulët të shkallës alkoolike, aromë, buket dhe preferohet pasi u përshtatet kërkesave të veçanta të klientëve.

Është bërë tashmë traditë që çdo vit në sezonin e verës "Birra Korça" organizon Festën e Birrës në qytetin e Korçës. Pjesëmarrja nga të gjitha trevat në këtë festë e kthen qytetin në festival të vërtetë birre, ku kurorën e mban vetëm birra "Korça".

... edhe sot më e mira!...

www.birrakorca.com.al



BIRRA KORÇA ÇMIMET

1935 - Thessaloniki, Greqi
"ÇMIMI I CILËSISË"

1938 - Thessaloniki, Greqi
"ÇMIMI I CILËSISË"

2005 - ISO 22.000

2007 - Londër, Angli
"ÇMIMI KURORA E
CILËSISË"

2009 - Frankfurt, Gjermani
"INTERNATIONAL ARCH OF
EUROPE"
çmimi në kategorinë "Diamant"

2015 - Athinë - Greqi
"TUV AUSTRIA"
EN ISO 9001:2008
EN ISO 27001:2005



TUV
AUSTRIA
HELLAS





UJI FAB

Ujë natyral oligomineral hyri në tregun shqiptar në pranverën e vitit 2014 si një nënprodukt i "Birra Korça". Lule Fabiola (latinisht Triteleia laxa) i dha jetë dhe imazh këtij produkti të ri në tregun vendas. "Natyralisht Fab" është zgjedhja e këtij produkti.

Falë specialistëve të fushës dhe teknologjisë së përparuar, ky produkt vjen si një zgjedhje e mirëmenduar për t'i ofruar konsumatorit shqiptar, më të mirën për shëndetin e tyre.

Çdo ditë e më shumë ky produkt po përhapet në treg me praninë e tij nën siglën "FAB".

Çdo ditë e më shumë ai bëhet pjesë e pandashme e familjeve tona. Burimi i Shën Mërisë njihet për ujin e pastër, me vlera të larta minerale dhe ushqimore.

www.fab.al



natyralisht

ujë natyral oligomineral
Burimet e Shën Mërisë

www.fab.al | 



Central Albania
EGNATIA
CABERNET SAUVIGNON

VERARIA EGNATIA

Nga viti 2002, Hysenbelliu Group ka gjithashtu në pronësi Verarinë Egnatia si një nga më të mëdhatë në ballkan në terma të teknologjisë dhe e pajisur me teknologjinë më të re të paketimit.

shpirti
i udhës
së lashtë



The image shows a large, modern building with a grid-like facade. A large, stylized 'HB' logo is prominently displayed on the upper left portion of the building's facade. The building has several horizontal bands of windows and a clean, architectural design.

HB

INDUSTRIA E NDERTIMIT

The logo for ERJANI NDERTIM features the name 'ERJANI' in a bold, blue, sans-serif font, with 'NDERTIM' in a smaller, blue, sans-serif font below it. A stylized graphic element, resembling a blue and white swirl or a stylized 'E', is positioned between the two words.

ERJANI
NDERTIM

The logo for EGNATIA GROUP features the word 'EGNATIA' in a bold, red, sans-serif font, with 'GROUP' in a smaller, black, sans-serif font below it. The text is set against a black rectangular background.

EGNATIA
GROUP

The logo for TIRANA GOLDEN PARK features the words 'TIRANA', 'GOLDEN', and 'PARK' stacked vertically in a gold, serif font.

TIRANA
GOLDEN
PARK

KOMPANIA E NDËRTIMIT “ERJONI”

Shoqëria “Erjoni” sh.p.k. e ka filluar aktivitetin e saj në vitin 1995. Shumë shpejt u rendit ndër kompanitë që kryente punime cilësore, si dhe u bë e suksesshme në këtë treg, duke u dalluar për rritjen e vëllimit të punimeve dhe duke zgjeruar gamën e fushës së ndërtimit.

Në vitin 2000 shoqëria u transferua në Tiranë, ku vazhdon edhe sot aktivitetin e saj. Tashmë pas një përvoje 20-vjeçare në tregun shqiptar, ajo është një konkurrente e denjë në treg. Drejtohet nga një staf shumë i kualifikuar. Bashkëpunon me firmat më prestigjioze në vend dhe punon për realizimin e projekteve tepër ambicioze, duke e zgjeruar aktivitetin e saj edhe në qytete të tjera.

Gjatë periudhës 2005-2006, shoqëria “Erjoni” sh.p.k., sërish në rolin e sipërmarrësit, kreu punimet e fabrikës së “Birra Korça”, sipas standardeve më të larta evropiane në fushën e ndërtimit. “Erjoni” sh.p.k. ka realizuar një nga komplekset më të bukur dhe më të mëdhenj të banimit e shërbimit, në mes të qytetit të Tiranës

www.erjoni-ndertim.com



EGNATIA NDERTIM

Një nga projektet më të rëndësishme që ka kompania "Egnatia" është të zhvillojë zonën e ish-Uzinës së Autotraktorëve, me vizion projektimin dhe ndërtimin e komplekseve të reja të banimit, të konceptuara sipas standardeve moderne, me vende pushimi midis pallateve.

Qëllimi i kompanisë është të ndërtojë me cilësi e korrektësi, duke u ofruar klientëve të saj apartamente komode dhe shtëpi të ndërtuara në kohë. "Egnatia" ofron më të mirën në treg sipas standardeve të BE-së.



TIRANA GOLDEN PARK

PROJEKTI "TIRANA GOLDEN PARK"

Shoqëria "ALB-MS 97" sh.a, pjesë e "Hysenbelliu Group" është partner në ndërtimin e kompleksit të ri të quajtur "Tirana Golden Park", e cila ndodhet në qendër të kryeqytetit. Ky është një ndër projektet më madhore e ambicioze të realizuara në vend, ku përveç apartamenteve të banimit dhe shërbimit, do të ketë ambiente sociale si: kopshte, çerdhe, mjedise sportive, etj.

"Tirana Golden Park" është projektuar me standardet më të larta, duke ofruar ambiente cilësore e të bukura njëkohësisht.

Një mundësi e "artë" jetese!



The image shows a large, modern building with a grid-like facade. A large, white 'HB' logo is mounted on a dark rectangular panel on the upper left side of the building. The building has several horizontal balconies or walkways on the right side.

HB

EDUKIMI



LUARASI



SHKOLLA E LARTE
UNIVERSITARE JOPUBLIKE
LUARASI

SHLUJ "LUARASI"

Universiteti Luarasi është një institucion i Arsimit të Lartë Jopublik (IAL). Universiteti "Luarasi" fillimisht u hap si Fakultet i Drejtësisë në vitin 2003. Nga viti akademik 2012-2013, "Luarasi" ka shtuar programet e studimit, duke hapur Fakultetin Ekonomik me disa degë, në nivel "Bachelor", "Master Shkencor" e "Master Profesional".

Të diplomuarit ndër vite janë punësuar në administratën publike apo kompani private. Studentët e "Luarasit" janë të vetmit nga IAL-të private, të cilët kanë fituar konkursin e Shkollës së Magjistraturës.

Shumë të tjerë kanë vazhduar studimet në universitetet më të mira të SHBA dhe në Europë përfshirë Oxford, Utrecht, Gjenevë, Urbino, etj., pa dhënë asnjë provim shtesë.

**Edukojmë mendje
Ndryshojmë jetë!**

www.luarasi-univ.edu.al



Tek "Luarasi" lektrojnë pedagogë të shquar të ekonomisë dhe drejtësisë në vend, përfshirë ish-gjyqtarë dhe gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese, pedagogë të Shkollës së Magjistraturës apo profesionistë të shquar të vendit.

Universiteti ofron mundësi promovimi për studentët me rezultate të shkëlqyera si pjesë e grupit më të madh mediatik në vend, si dhe punësim në sajë të bashkëpunimit me institucionet më të rëndësishme publike.

www.luarasi-univ.edu.al





HB

MEDIA ELEKTRONIKE & E SHKRUAR

Panorama

**PANORAMA
SPORT**

GAZETA SHQIPTARE

PsikologjiA

GRAZIA

news 24

BalkanWeb

RASH



www.panorama.com.al

Nga data 25 shkurt 2011, lajmet e gazetës Panorama, por edhe zhvillimet e fundit në kohë reale vijojnë të ndiqen edhe në faqen e internetit www.panorama.com.al.

Fillimisht u projektua si një hapësirë online ku kushdo përtej Shqipërisë mund të informohej me lajmet e gazetës, sot Panorama Online është shndërruar në një agjenci që publikon më shumë 100 lajme në ditë.

Në këtë faqe mund të gjeni minutë pas minute lajmin e fundit nga politika, aktualiteti, kronika, socialja, kultura, dhe sporti kjo për Shqipërinë, Kosovën, Bota dhe Rajonin.

Në 24 orë në këtë faqe numërohen rreth 400 mijë 'pageviews', 80 mijë janë përdorues unik.



GAZETA SHQIPTARE

"GAZETA SHQIPTARE" është gazeta më e vjetër e pavarur në Shqipëri. Ajo u themelua më 1927 dhe pas disa vitesh botimi i saj u ndal, pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste më 1939.

"Gazeta Shqiptare" rifilloi të botohet më 22 prill 1993, duke sjellë një frymë të re në gazetarinë e shkruar e duke u kthyer shpejt në shkollën e gazetarisë shqiptare.

Fillimisht "Gazeta Shqiptare" u botua vetëm me tetë faqe, katër në shqip e katër në italisht. Dy faqet kryesore ishin në gjuhën shqipe. Pati një numër të madh kopjesh të shitura që në ditët e para. Në maj të vitit 2011, "Gazeta Shqiptare", e cila ishte pjesë e grupit italian "Edisud spa", iu bashkua "Hysenbelliu Group".

Sa i përket lajmit, informacionit, shitjeve etj., "Gazeta Shqiptare" është një nga konkurrentet më të forta përkundrejt gazetave të tjera. Rreth 90% e stafit aktual që punon në "Gazeta Shqiptare" kanë përfunduar studimet në degën e Gazetarisë, në universitete si brenda dhe jashtë vendit.

"Gazeta Shqiptare" është e përditshme e pavarur, ku çdo të mërkurë, të shtunë dhe të diel ofron suplemente të ndryshme që u ofrohen lexuesve, ndërsa në muajt e verës ofron çdo ditë një suplement çlodhës dhe argëtues për lexuesit e saj.

Ndërkaq "Gazeta Shqiptare" ka bashkëpunëtorë një sërë analistësh me përvojë në fusha të ndryshme, duke e pasur pikë të fortë pjesën e analizës.



REVISTA MUJORE



Psikologjia

REVISTA "PSIKOLOGJIA"

Numri i parë u hodh në treg më 6 maj 2007, si një revistë mujore me 100 faqe, e gjitha me ngjyra. Është revistë me karakter psikologjik, me rëndësi të veçantë në trajtimin e temave simotra.

Pjesë e vyer e revistës "Psikologjia" janë autorë të njohur shqiptarë e të huaj, psikologë e sociologë, bashkëpunëtorë dhe personazhe publike, të cilët shkëmbejnë përvojat e tyre për të sjellë te lexuesit dëshmitë dhe këshillat e tyre personale. "Psikologjia" është e vetmja revistë e zhanrit të saj në Shqipëri.

Falë larmisë së artikujve, shumë shpejt "Psikologjia" u shndërrua në ndër produktet mediatike më dinjitoze e të kërkuara në treg. Target grupi i saj janë të gjitha moshat, përfshirë edhe fëmijët.

www.revistapsikologji.com

GRAZIA

REVISTA "GRAZIA"

Është produkti më i ri i hedhur në treg nga "Panorama Group" sh.a. Me një kombinim unik të rubrikave të ndryshme; modë, beauty dhe lifestyle, misioni i "Grazia"-s është të informojë lexuesin me të rejtat e fundit të modës dhe stilit të të jetuarit.

"Grazia Albania" renditet si edicioni i 23-të i Grazia Netëork. Në Azi, Europë, Australi,

"Grazia" renditet mes revistave më të preferuara nga lexuesit, duke qenë interpretuesja më e mirë e modës ndërkombëtare.

www.grazia.al

Koha për
t'u zgjuar

Çdo ditë
07:00



Vila 24

Çdo ditë
08:40



Klinika 24

E shtunë
20:00



news 24 HD

I vetmi televizion 100% full HD

Për informacion kontaktoni:

Tel: 04 2 359 104

Fax: 04 2 359 116

Cel: 068 20 74 395

e-mail: gazetashqiptare@hotmail.com

Marketing:

Tel: 04 2 359 148

Cel: 068 20 69 999

Cel: 068 20 53 122

e-mail: marketing.news24@yahoo.com

Adresa:

Ish Uzina Autotraktorëve, Tiranë-Albania



Në tempull
E premte
20:00



Xhungël
E hënë
21:00



Të bësh ekonomi
E mërkurë
21:00



Me zemër të hapur
Nga e hëna në të premte
12:05



Studio e Hapur nga Eni Vasili
E martë
21:00



Fair Play
E diel
22:00



Kaktus
E premte
21:00



Lajme

Lajme
Edicioni qendror
19:00



Arratia e peshkut të kuq
E shtunë
14:00



Diplomaticus
E enjte
20:30



CHiC
E Diel
20:00



Natë me Xhaxhiun
Nga e hëna në të premte
22:30



Lajme



Lajme



Njerëz në fokus
E hënë
20:00



Lajme



BalkanWeb

BALKANWEB është një nga faqet e para elektronike informative në vend. Një nga faqet më të klikuara që përfshin edhe publikimin e reklamave.

Numri i klikimeve në ditë shkon mbi 186.514, ndërsa në muaj është mbi 5.595.425.

www.balkanweb.com




97.0 FM



RADIO RASH transmeton pa ndërprerje, 24 orë në çdo ditë të vitit.

Radio "RASH" transmeton të gjitha llojet e muzikës. Ajo ofron gjithmonë më të mirën për adhuruesit e muzikës.





HB

RESTORANT / HOTELERI / TURIZEM





PRESTIGE HOTEL Është një oaz i gjelbëruar, fare pranë qendrës së Tiranës, në rrugën "Panorama".

I rrethuar nga një mjedis i gjelbër, "Hotel Prestige" ofron komoditetin dhe shërbimin më cilësor e luksoz për klientët e tij, gjithçka ku ndërthuret klasikja me modernen. Arredim i ndryshëm, parkete druri, mobilie italiane, e shumë komoditete krijojnë një ambient origjinal dhe tejet çlodhës për ata që zgjedhin të kalojnë ditë punë dhe jo vetëm në këto mjedise.

Hoteli ofron një atmosferë të ngrohtë, ku gjithkush ndjen kënaqësinë dhe komoditetin e kushteve maksimale.

Brenda një periudhe të shkurtër, "Hotel Prestige" u pozicionua mjaft mirë në treg, duke krijuar një standard të ri për hotelerinë shqiptare, me të njëjtat kritere si modelet ndërkombëtare.

www.hotelprestige.com.al





RESTORANT "PRESTIGE", i hapur në janar 2015 është një nga restorantet më të bukur në Tiranë.

I konceptuar si kompleks shërbimesh, restoranti është ndërtuar në një vilë tri-katëshe, me tri salla të mëdha restoranti, ambiente për pritjen e VIP-ve, salla mbledhjeje, kënde të veçanta për të ftuar specialë si dhe një ambient mahnitës në kopshtin e madh dhe të gjelbër jashtë, mbështetur në përvojën e restoranteve më prestigjioze e më luksoze në botë. Shija e hollë dhe dashuria me të cilën është kuruar çdo detaj, krijon një ambient të veçantë, që do të kthehet në një përvojë të paharrueshme për klientin.

I pozicionuar në një oaz të gjelbëruar, larg zhurmës së trafikut, në rrugën "Panorama", "Restorant Prestige" është një vend ideal për të kaluar çaste të mrekullueshme, ku ofrohen standardet më të larta të kulinarisë italiane, kuruar me mjaft mjeshtëri nga shefi italian i kuzhinës.

Çdo pjatë dhe element i saj është studiuar në detaj me delikatesë derisa të mbërrijë në tryezën e klientit. Gatimi dhe vera e përzgjedhur është 'qershia mbi tortë', duke synuar të jetë një eksperiencë e unike për klientët. "Restorant Prestige" synon të shkëlqejë në çdo gjë, përfshirë këtu dhe stafin e përzgjedhur dhe të trajnuar me shumë kujdes.

www.restorantprestige.com.al





PRESTIGE HOLIDAY RESORT


Dikur njëhej me emrin "Mak Albania", por tashmë ai është bërë pjesë e "Hysenbelliu Group" e mban emrin "Prestige Holiday Resort", me vendndodhje në Golem, buzë detit Adriatik. Shtrihet në një nga plazhet më të bukur në Shqipëri.

Ky kompleks turistik u përrua në vitin 1998. Për shumë vite, ky resort turistik, i konceptuar me vila të vogla, ka qenë për destinacioni më i frekuentuar në vend, duke ofruar bukurinë dhe relaksin për ditët e pushimeve. Në 2014, kompleksi u ble nga grupi "Hysenbelliu Group".

"Prestige Holiday Resort" është emri i ri me të cilin u pagëzua ky resort. Pas një rikonstruksioni total të ambienteve të mëparshme dhe pas një rikonceptimi modern, "Prestige Holiday Resort" synon të jetë destinacioni turistik më i frekuentuar në rajon.

Një nga komplekset me vizion dhe më tërheqës për pushuesit brenda dhe jashtë Shqipërisë, të cilët do të jenë në qendër të vëmendjes, sa i takon shërbimit dhe akomodimit.

www.prestigeresort.al



The image shows a modern building facade with a large, stylized 'HB' logo in white on a dark rectangular panel. The building has multiple floors with horizontal window bands. In the foreground, there is a large, semi-transparent 'HB' logo. At the bottom left, a group of four people is standing on a paved area. The overall image is in grayscale with a red bar at the bottom.A large, semi-transparent 'HB' logo is centered over the building facade. The logo is a stylized, bold font where the 'H' and 'B' are interconnected.

WWW.HYSENBELLIUGROUP.COM

Head Office:
"Panorama" Street, Business Tower,
ZIP code 1016, Tirana, Albania

Tel: +355 4 2273640
Email: office@ihb-group.com.al